

Trusting Our Father

By Elder David P. Homer
Of the Seventy

Mirëbesimi tek Ati Ynë

Nga Plaku Dejvid P. Homer,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

God trusts us to make many important decisions, and in all matters He asks us to trust Him.

On June 1, 1843, Addison Pratt left Nauvoo, Illinois, to preach the gospel in the Hawaiian Islands, leaving his wife, Louisa Barnes Pratt, to care for their young family.

In Nauvoo, as persecutions intensified, forcing the Saints to leave, and later at Winter Quarters as they prepared to migrate to the Salt Lake Valley, Louisa faced the decision of whether to make the journey. It would have been easier to stay and to wait for Addison to return than to travel alone.

On both occasions, she sought guidance from the prophet, Brigham Young, who encouraged her to go. Despite the great difficulty and her personal reluctance, she successfully made the journey each time.

Initially, Louisa found little joy in traveling. However, she soon began to welcome the green prairie grass, colorful wildflowers, and patches of ground along the riverbanks. “The gloom on my mind wore gradually away,” she recorded, “and there was not a more mirthful woman in the whole company.”

Louisa’s story has deeply inspired me. I admire her willingness to set aside her personal preferences, her ability to trust God, and how exercising her faith helped her to see the situation differently.

She has reminded me that we have a loving Father in Heaven, who cares for us wherever we

Perëndia na mirëbeson që të marrim shumë vendime të rëndësishme dhe, në të gjitha çështjet, Ai na kërkon që të mirëbesojmë tek Ai.

Më 1 qershor 1843, Edison Prati u largua nga Navuja në Ilinois, për të predikuar ungjillin në ishujt e Havait, duke lënë bashkëshorten e tij, Luiza Barns Pratin, që të kujdesej për fëmijët e tyre të vegjël.

Në Navu, teksa përndjekjet u shtuan duke i detyruar shenjtorët të largoheshin, dhe më vonë në Lagjet Dimërore teksa ata përgatiteshin për t’u shpërngulur drejt Luginës së Solt-Lejkut, Luiza u përball me vendimin a ta bënte apo jo udhëtimin. Do të kishte qenë më e lehtë të qëndronte e të priste Edisonin që të kthehej sesa të udhëtonte e vetme.

Në të dyja rastet, ajo kërkoi udhërrëfim nga profeti, Brigam Jangu, i cili e nxiti që të shkonte. Pavarësisht nga vështirësia e madhe dhe ngurrimi i saj vetjak, ajo e bëri me sukses udhëtimin në secilin rast.

Fillimisht, Luiza gjeti pak gëzim gjatë udhëtimit. Gjithsesi, shpejt filloi të mirëpriste barin e gjelbër të stepave, lulet e egra shumëgjyreshë dhe ngastrat e vogla të tokës përgjatë brigjeve të lumenjve. “Zymtia në mendjen time u largua dalëngadalë”, – shënoi ajo, – “dhe nuk kishte një grua më gazmore në të gjithë kompaninë.”

Historia e Luizës më ka frymëzuar thellësisht. E admiroj gatishmërinë e saj për të lënë mënjanë parapëlqimet e saj vetjake, aftësinë e saj për t’i mirëbesuar Perëndisë dhe mënyrën se si e ushtroi besimin për ta ndihmuar që ta shihte ndryshe gjendjen.

Ajo më ka kujtuar se kemi një Atë të dashur në Qiell, i cili kujdeset për ne kudo ku jemi, dhe

are, and that we can trust Him more than anyone or anything else.

The Source of Truth

God trusts us to make many important decisions, and in all matters He asks us to trust Him. This is especially difficult when our judgment or public opinion differs from His will for His children.

Some suggest that we should redraw the lines between what is right and what is wrong because they say that truth is relative, reality is self-defined, or God is so generous that He does not actually care about what we do.

As we seek to understand and accept God's will, it is helpful to remember that the boundaries between right and wrong are not for us to define. God has established these boundaries Himself, based on eternal truths for our benefit and blessing.

The desire to change God's eternal truth has a long history. It started before the world began, when Satan rebelled against God's plan, seeking selfishly to destroy human agency. Following this pattern, people like Sherem, Nehor, and Korihor have argued that faith is foolish, revelation is irrelevant, and whatever we want to do is right. Sadly, so very often these deviations from God's truth have led to great sorrow.

While some things may depend on context, not everything does. President Russell M. Nelson has consistently taught that God's saving truths are absolute, independent, and defined by God Himself.

Our Choice

Whom we choose to trust is one of life's important decisions. King Benjamin instructed his people, "Believe in God; believe that he is ... ; believe that he has all wisdom ... ; believe that man doth not comprehend all the things which the Lord can comprehend."

Fortunately, we have the scriptures and guidance from living prophets to help us understand

se mund t'i mirëbesojmë Atij më shumë sesa ndonjë njeriu ose gjëje tjetër.

Burimi i së Vërtetës

Perëndia na mirëbeson që të marrim shumë vendime të rëndësishme dhe, në të gjitha çështjet, Ai na kërkon që të mirëbesojmë tek Ai. Kjo është veçanërisht e vështirë kur gjykimi ynë ose opinioni publik ndryshojnë nga vullneti i Tij për fëmijët e Tij.

Disa njerëz sugjerojnë se duhet ta ndryshojmë përkufizimin e asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar, sepse thonë që e vërteta është relative, realitetin e përcaktojmë vetë, ose që Perëndia është aq zemërgjerë sa Ai faktikisht nuk e vret mendjen për atë që bëjmë ne.

Teksa përpiqemi ta kuptojmë dhe pranojmë vullnetin e Perëndisë, është e dobishme të kujtojmë se kufijtë midis së drejtës dhe së gabuarës nuk na takon t'i përcaktojmë ne. Perëndia i ka vendosur Vetë këta kufij, nisur nga të vërteta të përjetshme për përfitimin dhe bekimin tonë.

Dëshira për t'i ndryshuar të vërtetat e përjetshme të Perëndisë ka një histori të gjatë. E ka zanafillën që përpara se të fillonte bota, kur Satani ngriti krye kundër planit të Perëndisë, duke kërkuar me egoizëm që të shkatërronte lirinë e zgjedhjes së njerëzve. Duke ndjekur këtë model, njerëz si Sheremi, Nehori dhe Korihoi kanë argumentuar se besimi është marrëzi, zbulesa është e pavend dhe çfarëdo që dëshirojmë të bëjmë, është e drejtë. Për fat të keq, kaq shumë shpesh, këto shtrembërime të së vërtetës së Perëndisë kanë çuar në hidhërim të madh.

Ndërkohë që disa gjëra mund të varen nga konteksti, nuk varet gjithçka nga konteksti. Presidenti Rasëll M. Nelson ka dhënë vazhdimisht mësim se të vërtetat shpëtuese të Perëndisë janë absolute, të pavarura dhe të përcaktuara nga Vetë Perëndia.

Zgjedhja Jonë

Vendimi se kujt zgjedhim t'i mirëbesojmë është një nga vendimet më të rëndësishme të jetës. Mbreti Beniamin e udhëzoi popullin e vet: "Besoni në Perëndinë; besoni se ai është ... ; besoni se ai ka të gjithë diturinë ... ; besoni se njeriu nuk i kupton të gjitha gjërat që Zoti mund të kuptojë".

Për fat të mirë, ne kemi shkrimet e shenjta dhe udhërrëfimin nga profetët e gjallë për të na

God's truth. If clarification beyond what we have is needed, God provides it through His prophets. And He will respond to our sincere prayers through the Holy Ghost as we seek to understand truths we do not yet fully appreciate.

Elder Neil L. Andersen once taught that we should not be surprised "if at times [our] personal views are not initially in harmony with the teachings of the Lord's prophet. These are moments of learning," he said, "of humility, when we go to our knees in prayer. We walk forward in faith, trusting in God, knowing that with time we will receive more spiritual clarity from our Heavenly Father."

At all times, it is helpful to remember Alma's teaching that God gives His word according to the attention and effort we devote to it. If we heed God's word, we will receive more; if we ignore His counsel, we will receive less and less until we have none. This loss of knowledge does not mean that the truth was wrong; rather, it shows that we have lost the capacity to understand it.

Look to the Savior

In Capernaum, the Savior taught about His identity and mission. Many found His words difficult to hear, leading them to turn their backs and "[walk] no more with him."

Why did they walk away?

Because they did not like what He said. So, trusting their own judgment, they walked away, denying themselves blessings that would have come had they stayed.

It is easy for our pride to come between us and eternal truth. When we don't understand, we can pause, let our feelings settle, and then choose how to respond. The Savior urged us to "look unto [Him] in every thought; doubt not, fear not." When we focus on the Savior, our faith can start to overcome our concerns.

As President Dieter F. Uchtdorf encouraged us to do: "Please, first doubt your doubts before you doubt your faith. We must never allow doubt to hold us prisoner and keep us from the divine love, peace, and gifts that come through faith in the Lord Jesus Christ."

ndihmuar që ta kuptojmë të vërtetën e Perëndisë. Nëse nevojitet sqarim përtej asaj që kemi, Perëndia na e jep nëpërmjet profetëve të Tij. Ai do t'u përgjigjet lutjeve tona të sinqerta nëpërmjet Frymës së Shenjtë teksa përpiqemi t'i kuptojmë të vërtetat që ende nuk i vlerësojmë plotësisht.

Plaku Nil L. Andersen dikur dha mësim se nuk duhet të habitemi "nëse me raste pikëpamjet [tona] vetjake fillimisht nuk janë në harmoni me mësimet e profetit të Zotit. Këto janë çaste mësimi", – tha ai, – "përlujeje, kur ne biem në gjunjë për lutje. Ne ecim përpara me besim, duke mirëbesuar te Perëndia, duke e ditur se me kohën, do të marrim më shumë qartësi shpirtërore nga Ati ynë Qiellor."

Në çdo kohë, është e dobishme të sjellim ndërmend mësimin e Almës se Perëndia e jep fjalën e Tij në përputhje me vëmendjen dhe përpjekjen që i përkushtojmë asaj. Kur ia vëmë veshin fjalës së Perëndisë, do të marrim më shumë; nëse e shpërfillim këshillën e Tij, do të marrim gjithnjë e më pak derisa të mos kemi asnjë. Kjo humbje e njohurisë nuk do të thotë se e vërteta ishte e gabuar; përkundrazi, tregon se e kemi humbur aftësinë për ta kuptuar atë.

Shihni te Shpëtimtari

Në Kapernaum, Shpëtimtari dha mësim rreth identitetit dhe misionit të Tij. Shumë njerëzve iu dukën të vështira për veshin fjalët e Tij, gjë që i bëri t'ia kthenin shpinën dhe ata "nuk shkuan më me të".

Përse u larguan ata?

Ngaqë nuk iu pëlqeu ajo që tha Ai. Pra, duke mirëbesuar te gjykimi i tyre vetjak, ata u larguan, duke i mohuar vetes bekime që do t'u kishin ardhur po të kishin qëndruar.

Është e lehtë që krenaria jonë të bëhet pengesë midis nesh dhe së vërtetës së përjetshme. Kur nuk kuptojmë, mund të ndalemi, t'i lëmë ndjenjat tona të qetësohen dhe më pas të zgjedhim se si të reagojmë. Shpëtimtari na nxiti që të "sh[ohim] tek [Ai] në çdo mendim; [të] mos dyshojmë, [të] mos k[emi] frikë". Kur përqedrohemi te Shpëtimtari, besimi ynë mund të fillojë t'i mposhtë shqetësimet tona.

Siç na nxiti Presidenti Dieter F. Uchtdorf që të bëjmë: "Ju lutem, së pari kini dyshim te dyshimet tuaja përpara se të keni dyshim te besimi juaj. Ne kurrë nuk duhet ta lejojmë dyshimin që të na mbajë të burgosur dhe të na largojë nga dashuria hyjnore, paqja dhe dhuratat që vijnë nëpërmjet

Blessings Come to Those Who Stay

As the disciples walked away from the Savior that day, He then asked the Twelve, "Will ye also go away?"

Peter answered:

"Lord, to whom shall we go? thou hast the words of eternal life.

"And we believe and are sure that thou art that Christ, the Son of the living God."

Now, the Apostles lived in the same world, and they faced the same social pressures as the disciples who walked away. However, in this moment, they chose their faith and trusted God, thus preserving blessings God gives to those who stay.

Perhaps you, like me, sometimes find yourself on both sides of this decision. When we find it difficult to understand or embrace God's will, it is comforting to remember that He loves us as we are, wherever we are. And He has something better for us. If we reach out to Him, He will assist us.

While reaching out to Him can be difficult, just as the father who sought healing for his son was told by the Savior, "All things are possible to him that believeth." In our moments of struggle, we too can cry out, "Help thou [my] unbelief."

Submitting Our Will to His

Elder Neal A. Maxwell once taught that "the submission of one's will is really the only uniquely personal thing we have to place on God's altar." No wonder King Benjamin was so eager that his people become "as a child, submissive, meek, humble, patient, full of love, willing to submit to all things which the Lord seeth fit to inflict upon him, even as a child doth submit to his father."

As always, the Savior set the perfect example for us. With a heavy heart, and knowing the painful work He had to do, He submitted to His Father's will, fulfilling His messianic mission and opening the promise of eternity to you and me.

besimit te Zoti Jezu Krisht."

Bekime u Vijnë Atyre që Qëndrojnë

Kur dishepujt u larguan nga Shpëtimtari atë ditë, Ai atëherë i pyeti Të Dymbëdhjetët: "A doni edhe ju të largoheni?"

Pjetri u përgjigj:

"Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme.

Ne kemi besuar dhe kemi njohur se ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë."

Tani, apostujt jetuan në të njëjtën botë dhe u përballën me të njëjtat trysni shoqërore sikurse dishepujt që u larguan. Sidoqoftë, në atë çast, ata zgjodhën besimin e tyre dhe i mirëbesuan Perëndisë, duke i ruajtur kështu bekimet që Perëndia ua jep atyre që qëndrojnë.

Ndoshta ju, sikurse unë, nganjëherë e gjeni veten në të dyja anët e këtij vendimi. Kur e kemi të vështirë që ta kuptojmë ose përqafojmë vullnetin e Perëndisë, është ngushëlluese të kujtojmë se Ai na do siç jemi, kudo që jemi. Ai ka diçka më të mirë për ne. Nëse kërkojmë ndihmë prej Tij, Ai do të na e ofrojë.

Edhe kur shtrirja e dorës drejt Tij mund të jetë e vështirë, po ashtu si babait i cili kërkoi shërim për të birin, iu tha nga Shpëtimtari: "Çdo gjë është e mundur për atë që beson". Në çastet tona të vështirësisë, edhe ne mund të thërrasim: "Ndihmo mosbesimin tim".

Nënshtimi i Vullnetit Tonë ndaj Vullnetit të Tij

Plaku Nil A. Maksuell dikur dha mësim se "nënshtimi i vullnetit personal është me të vërtetë e vetmja gjë vetjake, e pashoqe, që duhet të vendosim mbi altarin e Perëndisë". Sëbashëm e habitshme pse mbreti Beniamin kishte kaq shumë dëshirë që populli i tij të bëhej "si një fëmijë, i nënshtuar, i bindur, i përlulur, i duruar, plot me dashuri, i gatshëm t'u nënshtrohet të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi të, madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij".

Si gjithmonë, Shpëtimtari dha shembullin e përsosur për ne. Me një zemër të rënduar dhe duke e ditur punën e dhembshme që duhej të bënte, Ai iu nënshtroi vullnetit të Atit të Tij, duke përmbushur misionin e Tij mesianik dhe duke çelur premtimin e përjetësisë për ju dhe për mua.

The choice to submit our will to God's is an act of faith that lies at the heart of our discipleship. In making that choice, we discover that our agency is not diminished; rather, it is magnified and rewarded by the presence of the Holy Ghost, who brings purpose, joy, peace, and hope we can find nowhere else.

Several months ago, a stake president and I visited a sister in his stake and her young adult son. After years away from the Church, wandering difficult and unfriendly paths, she had returned. During our visit, we asked her why she had come back.

"I had made a mess of my life," she said, "and I knew where I needed to be."

I then asked her what she had learned in her journey.

With some emotion, she shared that she had learned that she needed to attend church long enough to break the habit of not coming and that she needed to stay until it was where she wanted to be. Her return was not easy, but as she exercised faith in the Father's plan, she felt the Spirit return.

And then she added, "I have learned for myself that God is good and that His ways are better than mine."

I bear witness of God, our Eternal Father, who loves us; of His Son, Jesus Christ, who saved us. They know our hurts and challenges. They will never forsake us and know perfectly how to succor us. We can be of good cheer as we trust Them more than anyone or anything else. In the sacred name of Jesus Christ, amen.

Zgjedhja për t'ia nënshtruar vullnetin tonë atij të Perëndisë, është një veprim besimi që ndodhet në thelb të dishepullimit tonë. Duke bërë atë zgjedhje, ne zbulojmë se nuk pakësohet liria jonë e zgjedhjes; përkundrazi, ajo zmadhohet dhe shpërblehet nga prania e Frymës së Shenjtë, që sjell qëllim, gëzim, paqe dhe shpresë që nuk mund t'i gjejmë askund tjetër.

Disa muaj më parë, unë dhe një president kunji vizituam një motër në kunjin e tij dhe birin e saj të ri në moshë madhore. Pasi ishte larguar nga Kisha për vite të tëra, duke u endur nëpër shtigje të vështira dhe jomiqësore, ajo ishte rikthyer. Gjatë vizitës sonë e pyetëm se përse ishte rikthyer.

"E kisha bërë jetën lëmshe", – tha ajo, – "dhe e dija se ku duhej të isha."

Më pas e pyeta se çfarë kishte mësuar përgjatë rrugëtimit të saj.

Me njëfarë emocioni, tregoi se kishte mësuar që i nevojitej të frekuentonte kishën për aq kohë sa duhej për ta thyer zakonet e mosardhjes dhe që i nevojitej të qëndronte derisa të ishte vendi ku të dëshironte të ishte. Rikthimi i saj nuk ishte i lehtë, por teksa ushtronte besim në planin e Atit, ajo e ndjeu rikthimin e Shpirtit.

Dhe më pas ajo shtoi: "Kam mësuar vetë se Perëndia është i mirë dhe se udhët e Tij janë më të mira se të miat".

Jap dëshmi për Perëndinë, Atin tonë të Përgjeshëm, i cili na do; për Birin e Tij, Jezu Krishtin, i cili na shpëtoi. Ata i dinë lëndimet dhe sfidat tona. Ata nuk do të na braktisin kurrë dhe e dinë përsosurisht se si të na ndihmojnë. Ne mund të marrim zemër teksa u mirëbesojmë Atyre më shumë sesa ndonjë njeriu ose gjëje tjetër. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.